



RAPORTI TEKNIK

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT:

“NDËRHYRJE PËR PËRMIRËSIMIN E AKSESIT TURISTIK, RRUGË BIKIKLETASH, MOTORRASH,  
SHTIGJE KËMBËSORËSH, VENDPUSHIMESH, PIKA TURISTIKE.”



"SISTEMIMI DHE MBROJTJA E ARGJINATURES VERIORE TE LAGUNES SE KARAVASTASE PREJ  
EROZIONIT", FAZA I

PROJEKT ZBATIM

HARTUESI I PROJEKTIT:

B.O.E. "TAULANT" sh.p.k. & "ABKONS" sh.p.k.



TAULANT shpk  
Design & Supervision

abkons  
LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards

## TABLA E PËRMBATJES

1	VENDODHJA.....	5
1	FLORA DHE FAUNA .....	9
2	RESURSET NATYRORE.....	11
3	SITUATA AKTUALE E LAGUNËS.....	14
4	DETYRA E PROJEKTIT .....	17
4.1	Zgjidhja teknike e propozuar .....	17
4.2	Standartet që do të përdoren.....	21
4.3	Punimet e dheut në argjinaturë .....	21
4.4	Llogaritja e lartësisë së kurorës së argjinaturës .....	23
4.5	Seksioni tërthor tip i argjinaturës. ....	24
5	MBROJTJA E ARGJINATURËS NGA EROZIONI.....	25
5.1	Dyshekë gjeotekstili të mbushur me rërë (sand filled mattress ) .....	25
5.1.1	Standartet që duhet të plotësojë dysheku i mbushur me rërë ( Sand Fill Mattress).....	26
5.1.2	Kontroli dhe testimi i cilësisë .....	27
5.1.3	Transporti, Magazinimi dhe Trajtimi.....	28
5.1.4	Materiali mbushës .....	28
5.1.5	Instalimi .....	28
5.2	Kurora e argjinaturës .....	30
5.2.1	Mbrojtja e kurorës së argjinaturës nga erozioni .....	30
5.3	Vendosja e kornizës mbajtëse të rrugës.....	40
5.4	Vendosja e Geocell për të ndërtuar strukturën e bllokut mbështetës te rruges.....	42
5.4.1	Strukturat Geocell.....	42
5.4.2	Vecorite e struktures Geocell .....	43
5.4.3	Aplikacionet tipike të Geocell: .....	43
5.4.4	Standartet dhe Parametrat Teknike.....	44
5.4.5	Instalimi i Geocell Driveway: .....	46
5.4.6	Batanija me fara për mbrojtjen nga erozioni.....	48

## FIGURAT

Figura 1: Laguna e Karavastasë.....	5
Figura 2: Laguna e jashtëme .....	5
Figura 3: Laguna e brëndëshme .....	6
Figura 4: Plazhi Divjakës .....	6
Figura 5: Pylli me Pisha i Divjakës.....	6
Figura 6: Planimetri Kanali te Ura e Vaut.....	7
Figura 7: Kanali te Ura e Vaut.....	7
Figura 8: Kanali te Ura Dalanit.....	7
Figura 9: Planimetri Kanali te Ura Dalanit.....	8
Figura 10: Planimetri Kanali te Ura Dalanit.....	8
Figura 11: Sopi i Gjatë Pelikani Kacurel.....	9
Figura 12: Sopi i Gjatë Pelikani Kacurel .....	9
Figura 13: Sopi i Gjatë Pelikani Kacurel .....	10
Figura 14: Sopi i Gjatë Pelikani Kacurel .....	10
Figura 15: Impianti i Peshkimit në Kanalin te Ura Dalanit.....	11
Figura 16: Impianti i Peshkimit në Kanalin te Ura Dalanit.....	11
Figura 17 & Figura 18: Kulla e vrojtimit.....	12
Figura 19 & Figura 20: Udhëtim me varka .....	12
Figura 21: Qendër vizitoresh	Figura 22: Moment peshkimi .....
Figura 23: Pamje e lejlekeve në lagunë.....	13
Figura 24: Gjendja ekzistuese e argjinaturës së Lagunës .....	14
Figura 25: Pamje e argjinaturesne anen jugore te Lagunes .....	15
Figura 26: Pamje e argjinaturesne anen jugore te Lagunes .....	15
Figura 27: Pamje e argjinatures ne anen veriore te Lagunes prishur nga erozioni shkaktuar nga veprimi I dallges.....	16
Figura 28 Pamje e argjinaturës së dheut e shkatërruar nga veprimi i reshjeve atmosferike	16
Figura 29 Pamje e argjinaturës të dheut e shkatërruar nga filtrimi i ujit nga laguna në kanalin kullues i cili ka nivel më të ulët të ujit se niveli i ujit të lagunës. Filtrimi ndodh për shkak të argjilave që duke pasur sasi rëre janë të filtrueshme.....	16
Figura 30: Zona e projektit. ....	17
<i>Figura 31: Dyshekët e gjeotekstili të mbushur me rërë vendosur në argjinaturë .....</i>	18
Figura 32: Mbrojtja e trupit të argjinaturës dhe skarpateve nga erozioni me membranë gjeosintetike me argjile të papërshkueshme nga uji (GCL). ....	19
Figura 33: Mbrojtje e skarpateve me Geocell mbushur me dhe te ardhur t=20c.....	19
Figura 34: Batanie me fara e kontrollit te erozionit .....	20
Figura 35: Ndertimi i rruges ne kurore te argjinatures .....	20
Figura 36: Seksioni tip i argjinaturës.....	24
Figura 37: Pamje e argjinaturës me mbojtje me dyshëke gjeotekstili të mbushur me rëre...	25
Figura 38: Pamje e argjinaturës me mbojtje me dyshekë gjeotekstili të mbushur me rëre në një vepër arti .....	26
Figura 39: Pamje e argjinaturës me mbojtje me dyshekë gjeotekstili të mbushur me rëre të një argjinaturë .....	26
Figura 40: Instalimi i dyshekëve të gjeotekstilit të mbushur me rërë ( sand filled mattress ).	27
Figura 41: Instalimi i tubit që futet në hapësirën e brendëshme të krijuar ndërmjet dy shtresave të gjeomembranës.....	28
Figura 42: Procesi i mbushjes me rërë dhe uje i tubit nepermjet nje hinke .....	29
Figura 43: Dyshekët e gjeotekstili te mbushur me rere vendosur ne argjinature .....	29
Figura 44: Fiksimi i dyshekutt e gjeotekstili të mbushur me rërë në kurorë të argjinaturës. .	30
Figura 45: Shtresat e membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	32
Figura 46: Marketimi i membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	32

Figura 47: Dorezimi i GCL .....	34
Figura 48: Rruajtja e GCL .....	34
Figura 49: Ngjeshja e shtresave të dheut .....	35
Figura 50: Shtrimi i membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	36
Figura 51: Shtrimi i membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	36
Figura 52: Mbivendosjet e membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	37
Figura 53: Mbivendosjet e membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	37
Figura 54: Mbivendosjet e membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	38
Figura 55: Pamje nga ngjitja e membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	38
Figura 56: Pamje nga ngjitja e membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	39
Figura 57: Pamje perfundimtare e ngjitjes membranës me argjilë gjeosintetike (GCL) .....	39
Figura 58: Membrana me argjilë gjeosintetike (GCL) në prerjen tërthore tip të argjinaturës	40
Figura 59: Planimetria dhe prerja e kornizës mbajtëse të rrugës në kurorën e argjinaturës	41
Figura 60: Detaji A i kornizës mbajtëse të rrugës në kurorën e argjinaturës .....	41
Figura 61: Strukturë qelize e Geocell në formë rrjete e bërë nga polietileni me densitet të lartë .....	42
Figura 62: Paketimi I Geocell .....	42
Figura 63: Aplikimi I Geocell në projektet e mbrojtjes së shpateve .....	43
Figura 64: Pamje e vendosjes e Geocell ne sipërfaqen qe kerkohet .....	46
Figura 65: Aplikimi I shtresave ne Geocell .....	46
Figura 66: Ngjeshja e shtresave ne Geocell .....	47
Figura 67: Shtresat e rruges .....	47

## TABELAT

<i>Tabela 1: Pjerresitë maksimale të lejueshme për gjermim .....</i>	22
Tabela 2: Karakteristikat e dyshekut të mbushur me rërë .....	27
Tabela 3: Specifikimet teknike te materialit .....	33
Tabela 4: Specifikimet teknike të materialit bentoni .....	33
Tabela 5: Informacioni baze .....	44
Tabela 6: Parametrat teknike .....	45

## 1 VENDODHJA

Laguna e Karavastasë ndodhet në qendër të Ultesirës Perëndimore të vendit tonë dhe bën pjesë në parkun kombëtar të Divjakes. Është laguna më e madhe në Shqipëri dhe në gjithë bregdetin jugor të Adriatikut.



*Figura 1: Laguna e Karavastasë*

Laguna është e përbërë prej një lagune të brendshme dhe një lagune të jashtme më të vogël. Tre kanale e lidhin lagunën me detin Adriatik.



*Figura 2: Laguna e jashtme*



*Figura 3: Laguna e brëndëshme*

Siperfaqja e lagunës është 4330 ha, gjatësia 10.6 km, gjerësia 4.3 km dhe thellësia deri në 1.5 m. Kripësia në dimër shkon deri në 19 g/kg, kurse në verë mund të arrijë 35 g/kg.

Laguna ndahet me detin nga një brez i gjerë rëre, Plazhit i Divjakës, dhe nga pyllit me pisha i Divjakës




*Figura 4: Plazhi Divjakës*



*Figura 5: Pylli me Pisha i Divjakës*

Lidhet me detin me tri kanale, njëri prej të cilëve artificial, i hapur për nevojat e peshkimit. Nëpër këto kanale, si pasojë e baticës dhe zbatcës, rrjedhja e ujit ndryshon drejtim çdo 6 orë. Gjatë një cikli të baticë-zbaticës shkëmbimi i ujit me detin arrin afërsisht 1/50 e volumit të gjithë lagunës.



*Figura 6: Planimetri Kanali te Ura e Vaut*



*Figura 7: Kanali te Ura e Vaut*



*Figura 8: Kanali te Ura Dalanit*



*Figura 9: Planimetri Kanali te Ura Dalanit*



*Figura 10: Planimetri Kanali te Ura Dalanit*



## 1 FLORA DHE FAUNA

Laguna strehon një numër të madh zogjësh uji shtegëtarë. Në brendësi të saj ka dhe ishuj të vegjël, në të cilin folenizojnë shpendët.

Karakteristike në këtë zonë është kolonia e Pelikanit Kaçurel me rreth 60 çifte që përfaqëson rreth 5% të numrit të përgjithshëm të kësaj specie në shkallë botërore. E veçantë është dhe prania e disa qindra çifteve të dallandysheve të detit.

Lloje të tjerë të zogjëve që jetojnë në lagunë janë: Lejleke, Pata e eger, Çafka e Madhe e Bardhë, Rosa e Egër, Thëllëza, Lauresha, Shqiponja e madhe, Shqiponja e detit, etj. Të numëruar deri ne 228 specie zogjsh.

Janë rreth 29 lloje të ndryshme amfibësh dhe reptilësh (duke përfshirë Breshkën e ujit të detit) dhe 25 lloje gjitarësh duke përfshirë Vidrën, Nuselalën, Kaprollin dhe Dhelprën e kuqe.




Figura 11: Sopi i Gjatë Pelikani Kacurel



Figura 12: Sopi i Gjatë Pelikani Kacurel



*Figura 13: Sopi i Gjatë Pelikani Kacurel*



*Figura 14: Sopi i Gjatë Pelikani Kacurel*

Laguna e Karavastasë është shpallur një Zonë e Smeraldtë sipas Konventës së Bernës në 2008, një Zonë e Rëndësishme Zogjsh, si dhe një Ligatinor me Rëndësi Ndërkombëtare (mbrojtur nga Konventa e Ramsarit më 29 nëntor 1996).

## 2 RESURSET NATYRORE

Laguna e Karavastasë përbën një burim të ardhurash për popullsinë lokale që jeton brenda parkut tradicional. Këtu, njerëzit varen nga laguna për jetesën e tyre duke u marrë me restorante të vogla, duke zhvilluar guida për turistët dhe peshkim tradicional, duke respektuar teknikat dhe periudhat e peshkimit.




*Figura 15: Impianti i Peshkimit në Kanalin te Ura Dalanit*



*Figura 16: Impianti i Peshkimit në Kanalin te Ura Dalanit*

Kullat e drurit, të ngritura në mes të pyllit, ka rritur numrin e grupeve familjare që dëshirojnë të shkojnë për të kaluar një drekë dhe për të ngjitur këto kulla 30 metërshe që u mundësojnë atyre të shohin mbi parkun me pisha të larta.



*Figura 17 & Figura 18: Kulla e vrojtimit*

Në lagunë mund të organizohen gjithashtu udhëtime të vogla me varka ose kajak.



*Figura 19 & Figura 20: Udhëtim me varka*

Laguna e Karavastasë ofron mundësi shumë të mira eko-turizmi si dhe mundësi për të parë zogjtë dhe natyrën.



*Figura 21: Qendër vizituesh*



*Figura 22: Moment peshkimi*



*Figura 23: Pamje e lejlekeve në lagunë*

### 3 SITUATA AKTUALE E LAGUNËS

Si rezultat i dëmtimit ndër vite të argjinaturës së lagunës, pothuasje në të gjithë gjatësinë e saj, laguna shpesh nga batica, era dhe stuhitë detare, del nga shtrati, dhe përmbyt një pjesë të madhe të tokave bujqësore, të cilat janë nën nivelin e detit. Përmbytjet e tokave bujqësore, shkaktojnë dëme për fermerët të cilët jetesën e tyre e sigurojnë me veprimtarinë bujqësore.



Figura 24: Gjendja ekzistuese e argjinaturës së Lagunës

Për të eliminuar sipërfaqen e përmbytjes së tokave bujqësore, në anën Veriore të lagunës është ndërtuar një argjinaturë dhe me gjatësi 2.36 km. Kullimi i tokave pas argjinature është sistemuar me kanal anësorë paralel me argjinaturën. Është ndërtuar një hidrovor me kapacitet  $3 \times 1.25 = 3.75$  m<sup>3</sup>/s (dy pompa në punë një rezervë) i cili ujin që mblidhet në kanalin kullues e shkarkon brenda në lagunë.

Për të eliminuar sipërfaqen e përmbytjes së tokave bujqësore, në anën Jugore të lagunës është ndërtuar një argjinaturë dhe me gjatësi 3.6 km. Kullimi i tokave pas argjinature është sistemuar me kanal anësorë paralel me argjinaturën. Është ndërtuar një hidrovor me kapacitet 3.75 m<sup>3</sup>/s, i cili ujin që mblidhet në kanalin kullues e shkarkon në detin Adriatik.



*Figura 25: Pamje e argjinaturesne anen jugore te Lagunes*



*Figura 26: Pamje e argjinaturesne anen jugore te Lagunes*

Materiali me të cilin është ndërtuar trupi i argjinaturës, kryesisht është marrë duke gërmuar në kanalin kullues që është në anë të argjinaturës. Këto janë kryesisht llume argjilore të kripura

të përziera me rëra të cilat krijojnë dhera pa kohezion. Të përdorura në argjinatura nga veprimi i dallgës krijojnë gërryerje dhe filtrime të cilat për periudhe të shkurtër e shkatërrojnë argjinaturën, ndërsa nga veprimi i reshjeve atmosferike, uji futet në të çarat dhe plasaritjet e dherave dhe shkatërron argjinaturën.



*Figura 27: Pamje e argjinatures ne anen veriore te Lagunes prishur nga erozioni shkaktuar nga veprimi I dallges.*



*Figura 28*



*Figura 29*

*Figura 28 Pamje e argjinatures së dheut e shkatërruar nga veprimi i reshjeve atmosferike*

*Figura 29 Pamje e argjinatures të dheut e shkatërruar nga filtrimi i ujit nga laguna në kanalën kullues i cili ka nivel më të ulët të ujit se niveli i ujit të lagunës. Filtrimi ndodh për shkak të argjilave që duke pasur sasi rëre janë të filtrueshme.*

Janë bërë shpime me sonde në zonën e projektit. Shpimet janë bërë në lagunë për të përcaktuar shtresat gjeologjike si dhe janë marre mostra te dheut te argjinatures ekzistuese për të kryer analizat e dherave.



## 4 DETYRA E PROJEKTIT

Projekti “Sistemimi dhe mbrojtja e Argjinatures Veriore të Lagunës së Karavastasë prej Erozionit, Faza I”, synon të formatojë me skarpate të rregullta argjinaturën në anën veriore të lagunës nga Nga CS-1 deri te CS-67 gjithësej 3785 m argjinature, dhe detajon masat për mbrojtjen e argjinaturës nga erozioni i shkaktuar nga veprimi i dallgës + baticë zbatues në lagunë si dhe nga erozioni që shkaktojnë rrebeshët e shiut. Duke qenë një zonë e mbrojtur, materialet që do të përdoren për mbrojtjen e argjinaturës të jenë zgjedhur miqësore me mjedisin. Kurora e argjinaturës të shërbejë si atraksion turistik që të ecin këmbësorët për të shijuar bukuritë natyrore që ofron laguna. Mbi argjinaturë do të ndërtohen tre tenda pushimi e vrotimi me material druri, si dhe tre ura po me material druri, që lidhin argjinaturat me njera tjetren në pjeset ku futen në lagune perrenjte dhe kanalet e kullimit.



Figura 30: Zona e projektit.

### 4.1 Zgjidhja teknike e propozuar

Sistemimin dhe mbrojtjen e Argjinatures Veriore të Lagunës së Karavastasë prej Erozionit.

Nga CS-1 deri te CS-119 L 2369 m, dhe pas perroit te Xeng CS -1 deri te CS – 6 L = 100 m, do te hiqet shtresa vegjetale, do te behet skarifikimi, azhornimi topografik I faktit me projektin dhe pas miratimit nga mbikeqyresi, do te formatohet ne skarpata te rregullta siç eshte treguar ne fletet e vizatimit Planimetri, Profil Gjatesor dhe Prerjet Terthore te argjinatures. Pjerrësia e skarpatës në anën e brendëshme të argjinaturës (ana e lagunës) referuar llojit te tokës te tipit C është mbajtur Horizontale,  $H = 1.5$  m dhe Verikale,  $V = 1.0$  m, ndërsa pjerrësia e skarpatës në anën e jashtëme të argjinaturës është mbajtur  $H = 2.0$  m  $V = 1.0$ m.

Mbrojtja e argjinaturës nga erozioni i shkaktuar nga veprimi i dallgës + baticë zbatues në lagunë si dhe nga erozioni që shkaktojnë rrebeshet e shiut për argjinaturen ndërmjet ketyre piketave, do të realizohet me dyshekë gjeotekstili të mbushur me rërë (sand filled mattress) sipas seksionit tip të treguar në figurën 1. Në këtë argjinaturë do të ndërtohet një urë druri me gjatësi  $L = 34$  m, nën të cilën futet në lagunë Perroi i Xengut (DK3 – 5) dhe kanali kullues DK3-4. Gjatësia e kësaj argjinature së bashku me urën do të jetë 2503 m (2369 + 34 m ura + 100 m). Mbi këtë argjinaturë do të ndërtohen tre pika vrojtimi dhe pushimi mbi argjinaturë, në pozicionet siç është treguar në fletët e vizatimit.




Figura 31: Dyshekët e gjeotekstili të mbushur me rërë vendosur në argjinaturë

Nga CS-6 deri te CS - 67 L 1316 m argjinaturë + 2 ura druri secila me hapësirë 17 m, ka gjurmë të argjinaturës ekzistuese në lartësi nga 30 cm deri në 70 cm. Ndërtimi i argjinaturës në këtë pjesë do të realizohet duke hequr shtresën vegjetale, duke bërë skarifikimin, azhurnimin


topografik të faktit me projektin dhe pas miratimit nga mbikëqyrësit do të vazhdojë mbushja me dhera për të formuar trupin e argjinaturës, siç është treguar në fletët e vizatimit Planimetri, Profil Gjatësor dhe Prerjet Tërthore të argjinaturës.

Pjerrësia e skarpatës në anën e brendëshme të argjinaturës (ana e lagunës) referuar llojit të tokës të tipit C është mbajtur Horizontale,  $H = 1.5$  m dhe Verikale,  $V = 1.0$  m, ndërsa pjerrësia e skarpatës në anën e jashtme të argjinaturës është mbajtur  $H = 2.0$  m  $V = 1.0$  m.

Mbushja do të realizohet me shtresa dheu 18 – 23 cm, të cilat pasi të rullohen me rul, të arrijmë shtresa të ngjeshura 15 – 17 cm. Dherat që do ngjeshen nëse janë të thata duhet të njomen gjatë ngjeshjes për të arritur lagështinë optimale, nëse janë tepër të lagura atëherë duhet të lihen të thahen, ose të plugohen dhe pastaj të ngjeshen.


Materiali do të kompaktësohet, në një përmbajtje me lagështi optimale, derisa të arrihet një minimum densiteti të thatësisë prej 90% të AASHTO të modifikuar kundrejt densitetit të thatësisë maksimale.

Mbrojtja e argjinaturës nga erozioni i shkaktuar nga veprimi i dallgës + baticë zbatues në lagunë si dhe nga erozioni që shkaktojnë rrebeshet e shiut për argjinaturen ndërmjet ketyre piketave, do të realizohet me membranë gjeosintetike me argjile të papërshkueshme nga uji (GCL) (Waterproof Geosynthetic Clay Liners Material GCL), siç është treguar në figurën 32.



*Figura 32: Mbrojtja e trupit të argjinaturës dhe skarpateve nga erozioni me membranë gjeosintetike me argjile të papërshkueshme nga uji (GCL).*

Mbrojtja e skarpateve të argjinaturës do të bëhet me Geocell mbushur me dhe të ardhur t=20 cm, i përshtatshëm për zhvillimin e barit sipas seksionit tip të treguar në Figurën.33.



*Figura 33: Mbrojtje e skarpateve me Geocell mbushur me dhe te ardhur t=20cm*

Pasi mbushet Geocell me dhe të ardhur t=20 cm, i përshtatshëm për zhvillimin e barit, mbrojtja e skarpateve nga erozioni do të bëhet më batanie me fara e kontrollit të erozionit, siç është treguar në Figuren 34, në Relacionin Teknik dhe në Fletët e Vizatimit. Në këtë argjinaturë do të ndërtohen dy ura druri secila me gjatësi  $L = 17 \text{ m} \times 2 \text{ cope} = 34 \text{ m}$ . Gjatësia e kësaj argjinature së bashku me urën do të jetë 950 m ( 916 +17 ura + 17 m ura).




Figura 34: Batanie me fara e kontrollit te erozionit

Në kurorën e argjinaturës do të ndërtohet rrugë për këmbësorët.

Mbi membranën me argjilë gjeosintetike (GCL) që është vendosur për mbrojtjen e argjinaturës nga erozioni, do të vendoset një kornizë me profile metalike për të mbajtur paketën e rrugës. Për ta mbajtur të qëndrueshme strukturën e bllokut mbështetës të rrugës, mbi membranën me argjilë gjeosintetike (GCL) do të vendoset Geocell.

Geocelli në kurorën e argjinaturës do të mbushet 15 cm me përzierje çakell + stabilizant + filler, dhe 5 cm stabilizant syprina e rrugës, siç është treguar në Figurën 35, në Relacionin Teknik dhe në Fletët e Vizatimit.

**NDERTIMI I RRUGES NE KURORE TE ARGJINATURES**




Figura 35: Nd`rtimi i rrugës në kurorë të argjinaturës

## 4.2 Standartet që do të përdoren

- Punimet në realizimin e këtij projekti do të jenë në përputhje me standartet:

Lagoon and Liner Design Guidelines: Washington State Department of Ecology -April 2023 | Publication 98-37

BS 5930: 2015

Kodi i praktikës për investigimet në terren

BS EN 16907-1 Earthworks Principles and general rules

Kushtet Teknike të Projektimit të Digave prej Dheu Tiranë 1977

BS EN 13361: Karakteristikat e nevojshme për përdorim në ndërtimin e rezervuarëve dhe digave.

BS EN 13362: Karakteristikat e nevojshme për përdorim në ndërtimin e kanaleve.

BS EN 13492: Karakteristikat e kërkuara për përdorim në ndërtimin e vendeve të depozitimit të mbetjeve të lëngshme, stacioneve të transferimit ose mbajtjes dytësore

- Cilësia e membranave gjeosintetike që do të përdoren do të jetë siç është specifikuar në specifikimet teknike të projektit dhe në përputhje me standartet:

EN 16416:2013 – "Pengesat e argjilës gjeosintetike - Përcaktimi i indeksit të fluksit të ujit - Metoda fleksibël e permeamtrit të murit me kokë konstante"

EN ISO 9863-1:2016 –"Gjeosintetika - Përcaktimi i trashësisë në presione të specifikuara - Pjesa 1: Shtresa të vetme"

EN ISO 9864:2005 – "Gjeosintetika - Metoda e provës për përcaktimin e masës për njësi sipërfaqe të gjeotekstilit dhe produkteve të lidhura me gjeotekstilet"

EN ISO 10318-1:2015 – "Gjeosintetika - Pjesa 1: Termat dhe përkufizimet"

EN ISO 10319:2015 – "Gjeosintetika - Prova e tërheqjes me gjerësi të gjerë"

EN ISO 12236:2006 – "Gjeosintetika - Testi i shpimit statik (test CBR)"

## 4.3 Punimet e dheut në argjinaturë

Ka argjinaturë ekzistuese në zonën e projektit. Pjesa tjetër do plotësohet. Kjo argjinaturë është ndërtuar me dherat që janë marrë duke gërmuar në kanalën kullues që shtrihet paralel me argjinaturën. Argjinatura ekzistuese nuk është e formatuar në skarpate të rregullta. Duke qënë se këto dhera kanë në përberje rëra, janë pa kohezion dhe argjinatura në disa vende siç është treguar në gjëndjen ekzistuese ka filluar të shkatërrohet nga erozioni i veprimit të dallgëve si dhe veprimit të baticë zbatice.

Kuota e argjinatures ekzistuese është rreth +1.5 m mbi nivelin e detit, por duke mos patur një formatim të rregullt në shumë vende ndryshon në gjerësi dhe lartësi.

Projekti "Sistemimi dhe mbrojtja e Argjinatures Veriore të Lagunës së Karavastasë prej Erozionit, Faza I", synon të ndërtojë dhe të formatojë argjinaturën në skarpate të rregullta dhe ta mbrojë nga erozioni i shkaktuar nga veprimi i dallgës + baticë zbatice në lagunë si dhe nga erozioni që shkaktojnë rrebeshet e shiut.

Per percaktimin e pjerrësive te skarpatave te argjnatuës jemi bazuar ne percaktimin e llojit te tokes dhe kushte teknike ne fuqi.

Percaktimi i llojit te tokes eshte bazuar ne:

OSHA Technical Manual (OTM) Section V: Chapter 2

Excavations: Hazard Recognition in Trenching and Shoring

IV. Determination of Soil Type

Manuali Teknik i OSHA (OTM) Seksioni V: Kapitulli 2

Gërmimet: Njohja e Rrezikut në Hedhjet dhe Mbledhjet

IV. Përcaktimi i llojit të tokës

Eshte bere studimi I dherave te zones se projektit. Jane bere cpime gjeologjike per te percaktuar si jane vendosja dhe trashesite e shtreses brenda ne lagune dhe si jane karakteristikat e dherave te argjinatures ekzistuese dhe dherave qe do te perdoren per ndertimin e argjinatures se re.

Nga studimi gjeologjik i kryer rezulton se dherat jane te tipit C. ( bashkengjitur projekti eshte Raporti Gjeologo-Inxhinierik )

Pjerrësitë e argjnatuës janë përshtatur me shpatet maksimale të lejueshme për gërmim më pak se 20 këmbë (6,09 m) jane bazuar në llojin e tokës te tipit C.

Soil Type	Height/Depth ratio	Slope Angle
Stable Rock	Vertical	90 deg.
Type A	¾ : 1	53 deg.
Type B	1 : 1	45 deg.
Type C	1½ : 1	34 deg.


  


Tabela 1:Pjerrësitë maksimale të lejueshme për gërmim

Pjerrësia e skarpatës në anën e brendëshme të argjnatuës (ana e lagunës) referuar llojit te tokës te tipit C është mbajtur Horizontale, H =1.5 m dhe Verikale, V=1.0 m, ndërsa pjerrësia e skarpatës në anën e jashtëme të argjnatuës është mbajtur H = 2.0 m V = 1.0m.

Gjatë formatimit të seksioneve të argjnatuës ekzistuese nga ana e brendëshme (ana e lagunës) nga CS -1 deri CS -119 skarpatet do të formohen gjithmonë në gërmim (skarifikim), çdo seksion formohet dhe plotësohet me skarpatën e jashtëme të argjnatuës, siç është treguar në fletët e projektit.

Per pjesen e argjinatures qe do te mbushet dhe formatohet pas ures qe do vendoset mbi perroin Xeng nga CS-1 deri CS-6, perseri pjerrësite do te mbahen në anën e brendëshme të argjnatuës (ana e lagunës) Horizontale, H =1.5 m dhe Verikale, V=1.0 m, ndërsa pjerrësia e skarpatës në anën e jashtëme të argjnatuës do te jete H = 2.0 m V = 1.0m.



Materiali do të kompaktesohet, në një përmbajtje me lagështi optimale, derisa të arrihet një minimum densiteti të thatësisë prej 90% të AASHTO të modifikuar kundrejt densitetit të thatësisë maksimale.

Nga CS-6 deri te CS - 67 L 1316 m, ka gjurme te argjinatures ekzistuese ne lartesi nga 30 cm deri ne 70 cm. Ndertimi I argjinatures ne kete pjese do te realizohet duke hequr shtresen vegjetale, duke bere skarifikimin, azhornimin topografik te faktit me projektin dhe pas miratimit nga mbikeqyresit do te vazhdoje mbushja me dhera per te formuar trupin e argjinatures, siç eshte treguar ne fletet e vizatimit Planimetri, Profil Gjatesor dhe Prerjet Terthore te argjinatures.

Pjerrësia e skarpatës në anën e brendëshme të argjinaturës (ana e lagunës) referuar llojit të tokës të tipit C është mbajtur Horizontale, H =1.5 m dhe Verikale, V=1.0 m, ndërsa pjerrësia e skarpatës në anën e jashtëme të argjinaturës është mbajtur H = 2.0 m V = 1.0m.

Mbushja do te realizohet me shtresa dheu 18 – 23 cm, te cilat pasi te ruloohen me rul, te arrijme shtresa te ngjeshura 15 – 17 cm. Dherat qe do ngjeshen nese jane te thata duhet te njomen gjate ngjeshjes per te arritur lageshtine optimale, nese jane teper te lagura atehere duhet te lihen te thahen, ose te plugohen dhe pastaj te ngjeshen.

Materiali do të kompaktesohet, në një përmbajtje me lagështi optimale, derisa të arrihet një minimum densiteti të thatësisë prej 90% të AASHTO të modifikuar kundrejt densitetit të thatësisë maksimale.

#### 4.4 Llogaritja e lartësisë së kurorës së argjinaturës

Lartësia e kuotës së argjinaturës është llogaritur me formulën:

Llogaritja e lartësisë është bërë me formulën:

$H = NNU + b + hk + a$  Sipas KTP diga dheu 197

H - Kuota absolute e Kurorës

NNU - Niveli Normal i Ujit (Kuote absolute) 0.00 m

b - Lartësia e Batices (m) 0.20 m qe eshte batica ne bregdet

hk – Lartësia e ngjitjes së dallgës (m)

a - Lartësia rezervë 0.50 m

$hk = 3.2 \times k \times h \times tga$

k - Koef. në varësi të ashpërsisë së skarpatës 0.85

#### h - Lartësia e ngjitjes se dallgës (m)

$h = 0.0208 \times V^{5/4} \times D^{1/3}$  Sipas formule V.G.Andrejanov

V – shpejtësia e erës (m/sek) 6.0 m/s 21.6 (km/ore) ( Veçori Klimatike Ultësira Perëndimore f.43 + JICA

D – Gjatësia e shtrirjes së valës 10.60 km

$h = 0.0208 \times V^{5/4} \times D^{1/3} = 0.0208 \times 6.0^{5/4} \times 10.6^{1/3} = 0.43 \text{ m}$

**hk = 3.2 x k x h x tgα** Sipas formules N.N. Dzhukovski

k - Koef. në varësi të ashpërsisë së skarpatës 0.85

h – Lartësia e dallgës 0.43 m

tgα - Tang. Këndi i pjerrësisë së skarpatës 0.67

**hk = 3.2 x k x h x tgα = 3.2 x 0.85 x 0.43 x 0.67 = 0.78 m**

H = NNU + b + hk + a

NNU - Nivelu Normal i Ujit (Kuotë absolute) 0.00 m

b - Lartësia e Baticës 0.20 m

hk – Lartësia e ngjitjes së dallgës 0.78 m

a - Lartësia rezerve 0.50 m

**H = NNU + b + hk + a = 0.00 m + 0.20 m + 0.78 m + 0.50 m = 1.48 m e pranojme 1.50 m**

Lartësia e kurorës nga llogaritja del se duhet te jete **1.5 m**

#### 4.5 Seksioni tërthor tip i argjinaturës.

Seksionet tipe të argjinatures janë marrë në përshtatje me përmasat aktuale të argjinaturës, duke bërë formatimin e argjinaturës dhe duke mbajtur nën kontroll sasinë e dherave ekzistuese. Do të ketë 5 tipe seksione tërthore të argjinature me gjerësi të kurorës 3.0 m, 3.5 m, 4.0 m, 4.5 m dhe 5.0m. Pjerrësia dhe lartësia do të jetë e njëjtë për të gjitha seksionet.

SEKSIONI TIP I ARGJINATURES




Figura 36: Seksioni tip i argjinaturës.



## 5 MBROJTJA E ARGJINATURËS NGA EROZIONI

### 5.1 Dyshekë gjeotekstili të mbushur me rërë (sand filled mattress )

Në ditët e sotme, përparimet në teknologjinë gjeosintetike dhe zhvillimi i materialeve inovative me qëndrueshmëri dhe përshkueshmëri të përmirësuar ofrojnë performancë dhe jetëgjatësi më të lartë. Për mbrojtjen e argjinatures nga erozioni shkarkuar nga veprimi i dallges + batice zbatues ne lagune si dhe nga erozioni që shkaktojnë rrebeshet e shiut ne skarpitet e argjinatures do te perdoren dysheke gjeotekstili te mbushur me rere ( sand filled mattress ).

Një dyshek i mbushur me rërë, është një strukturë fleksibël dhe e qëndrueshme që përdoret për aplikime të ndryshme inxhinierike civile dhe mjedisore.

Përdoret gjerësisht për mbrojtjen e vijës bregdetare, stabilizimin e brigjeve të lumit, punimet e bonifikimit, kontrollin e erozionit dhe stabilizimin e pjerrësisë etj. Dysheku përbëhet nga një pëlhurë gjeotekstili e depërtueshme, e cila lejon që uji të rrjedhë duke mbajtur mbushjen e rërës.

Dyshekët e mbushur me rërë ofrojnë një zgjidhje me kosto efektive dhe miqësore me mjedisin për këto aplikime, duke siguruar qëndrueshmëri dhe mbrojtje afatgjatë.

Pas instalimit, ai siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përhershme të argjinatures, duke sjellë një pamje estetike. Ne fotot 33, 34 dhe 35 janë treguar aplikime të dyshekeve prej gjeotekstili të mbushur me rere, në skarpate të rezervuareve me uje të vaditjes dhe skarpateve të argjinaturave të kanaleve kulluese në tokat bujqesore.



Figura 37: Pamje e argjinaturës me mbrojtje me dysheke gjeotekstili të mbushur me rërë



Figura 38: Pamje e argjinaturës me mbajtje me dyshekë gjeotekstili të mbushur me rëre në një vepër arti.




Figura 39: Pamje e argjinaturës me mbajtje me dyshekë gjeotekstili të mbushur me rëre të një argjinaturë

Përparësitë:

1. I lehtë dhe me kosto efektive për tu transportuar në vend
2. I shpejtë dhe i lehtë për t'u instaluar
3. Zgjidhje efektive dhe ekonomike për mbrojtjen nga erozioni e skarpatës së argjinaturës
4. Fleksibil dhe mund të ndjekë lehtësisht kthesat dhe përkuljet
5. Mund të mbushet me rërë të disponueshme locale
6. Instalohet në ujë dhe ne skarpate te argjinatures
7. Nuk kërkon makineri të rënda për instalim

### 5.1.1 Standartet që duhet të plotësojë dysheku i mbushur me rërë ( Sand Fill Mattress)

BS EN 13361-2018, BS EN 13254-2016, BS EN 13362-2018, BS EN 13255-2016, ASTM D-5261, ASTM D-4595, ASTM D-6767-2011, ASTM D-4886 dhe ASTM D-4355-92

Më poshtë janë treguar karakteristikat që duhet të plotësojë dysheku i mbushur me rërë që do të përdoret në këtë projekt:

**Karakteristikat e dyshekut të mbushur me rërë**

Nr.	Vetitë	Metoda e testimit	Njësia	Shtresa e përbërë e sipërme e gjelbër (VP+W)	Shtresa e Endur e Zezë e poshtme (TxT)
1	Masa për njësi sipërfaqe	ASTM D 5261	g/m <sup>3</sup>	> 650	> 650
2	Rezistenca në tërheqje	ASTM D 4595	kN/m	90	110
3	Madhësia e poreve	ASTM D 6767-2011	mm	< 0.35	< 0.35
4	Rezistenca ndaj gërryerjes (Ruajtja e forcës në tërheqje)	ASTM D 4886	kN/m	10	N.A.
5	Stabiliteti UV (Ruajtja e Forcës)	ASTM D-4355-92 @500 hours	%	70	70
6	Dimensioni i rrotullës	W x L	MTR	5.0 x 20	
7	Pozicioni i thurjes	350 mm			
8	Fije Qepjeje	Minimumi 2500 Denier poliestër me qëndrueshmëri të lartë / PP me shumë filamente			
9	Lloji i thurjes	Qep makinë me zinxhir të vetëm			

*Tabela 2: Karakteristikat e dyshekut të mbushur me rërë.*

*Figura 40: Instalimi i dyshekëve të gjeotekstil të mbushur me rërë ( sand filled mattress ).*
**5.1.2 Kontrolli dhe testimi i cilësisë**

Pëlhura gjeotekstile e përdorur për prodhimin e dyshekut të gjeotekstil duhet të ketë veti të larta mekanike për qëndrueshmëri të shtuar së bashku me shpim, gërryerje dhe rezistencë të shtuar ndaj rrezeve ultraviole.

Fijet për qepje duhet të jenë në përputhje me specifikimet standarde dhe të sillen në vend në paketimin origjinal të prodhuesit.

Prodhuesi duhet të ketë sisteme cilësie të çertifikuara ISO 9001:2015 së bashku me pajisjet e testimit të brendshëm dhe do të ketë laborator të brendshëm të akredituar ISO/IEC 17025:2017.

Prodhuesi duhet të dorëzojë Certifikatën CE nga një prej agjencive evropiane për gjeotekstilet jo të endura.

Prodhuesi duhet të lëshojë një raport testimi që tregon vetitë e materialit, në momentin e dërgesës së kryer.

Prodhuesi duhet të ketë një strukturë të brendshme testimi që ka dispozita testimi për metodat e provës siç përmendet më poshtë.

### 5.1.3 Transporti, Magazinimi dhe Trajtimi

Dysheku i gjeotekstilit do të dorëzohet në vend në formë rrotullash. Të gjitha rrotullat duhet të kenë një mbulesë mbrojtëse me një etiketë ose etiketë që specifikon emrin e produktit, emrin e prodhuesit, numrin e rrotullës, dimensionin e rrotullës dhe datën e prodhimit.

Materiali duhet të mbrohet nga rrezet e diellit, balta, papastërtia, mbeturinat, çdo substancë tjetër e dëmshme ose dëmtimi mekanik gjatë transportit dhe ruajtjes. Nuk duhet të përdoren grepa, darë ose instrumente të tjera të mprehta etj. për trajtimin e rrotullës së dyshekut gjeotekstili. Rrotullat e dyshekut të furnizuar nga gjeotekstilet nuk duhet të tërhiqen zvarrë përgjatë tokës dhe duhet të

hapet duke hequr mbështjellësin dhe shtrihet butësisht përgjatë pjerrësisë nga lart poshtë, sipas udhëzimeve. Rrotullat e dyshekut të gjeotekstilit ngjitur do të bashkohen me qepje në vend. Gjithashtu, dysheku i gjeotekstilit nuk duhet të ekspozohet ndaj temperaturave mbi 60°C.

Çdo material, i cili dëmtohet gjatë transportit, trajtimit ose magazinimit dhe nuk plotëson kërkesat minimale të specifikimeve, është përgjegjës për refuzimin nga inxhinieri.

### 5.1.4 Materiali mbushës

Materiali mbushës i përdorur për të mbushur dyshekun e gjeotekstilit duhet të jetë rërë e trashë e disponueshme në vend. Toka e shkrifët dhe argjilore duhet të shmanget si material mbushës. Dysheku i gjeotekstilit duhet të mbushet mekanikisht ose hidraulikisht deri në trashësinë e projektuar në vend dhe mbushja e tepërt duhet të kontrollohet. Xhepat tubolarë të dyshekut gjeotekstili duhet të mbushen nga lart poshtë.

### 5.1.5 Instalimi

Sipërfaqja në të cilën do të instalohet dysheku i gjeotekstilit, duhet të pastrohet, që të mos ketë asnjë papastërti në sipërfaqen që do të shtrohet.

Dysheku i gjeotekstilit do të vendoset përgjatë profilit të pjerrësisë nga lart poshtë në mënyrë që të shtrihet nën e efektin e peshës së tij. Rrotullat e dyshekëve ngjitur duhet të bashkohen duke u qepur në vend. Kur dysheku vendoset në pozicion, fillon procesi i mbushjes me rërë. Rëra futet në hapësirën e brendshme të krijuar ndërmjet dy shtresave të pëlhurës. Kjo zakonisht bëhet duke përdorur Tuba HDPE i cili futet në xhepin e dyshekut dhe me anën e një hinke futet rere dhe uji për të larë rërën dhe ta ndihmuar të ngjeshet. Tubi terhiqet gradualisht lart deri sa të formohet tubi me rere në dyshek. Pasi është mbushur me rere dysheku i gjeotekstilit qepet me makine të detikuara dhe me fije poliestër me qëndrueshmëri të lartë të cilat furnizohen së bashku me dyshekun e gjeotekstilit.



*Figura 41: Instalimi i tubit që futet në hapësirën e brendshme të krijuar ndërmjet dy shtresave të gjeomembranës.*



Figura 42: Procesi i mbushjes me rërë dhe uje i tubit nepermjet nje hinke




Figura 43: Dysheket e gjeotekstili te mbushur me rere vendosur ne argjinature

Inkastrimi i dyshekëve të gjeotekstilit të mbushur me rërë inkastrohen në kurorën e argjinaturës. Në kurorën e argjinaturës hapen kanale në të cilin instalohet dysheku i gjeotekstilit dhe pas kësaj mbushet dhe ngjeshet me dheun e dalë nga gërmimi siç është treguar në figurën 40.

DETAJI I FIKSIMIT TE DYSHEKEVE TE GJEOTEKSTILI TE MBUSHUR ME RERE

( Sand Filled Mattress )




Figura 44: Fiksimi i dyshekut e gjeotekstili të mbushur me rërë në kurorë të argjinaturës.

Pas mbushjes me dhe të kanale në të cilin eshte instaluar dysheku I gjeotekstilit materiali do te kompaktesohet, ne nje permbajtje me lageshti optimale, derisa te arrihet nje minimum densiteti te thatesise prej 90% te AASHTO te modifikuar kundrejt densitetit te thatesise maksimale.

## 5.2 Kurora e argjinaturës

### 5.2.1 Mbrojtja e kurorës së argjinaturës nga erozioni

Para se të ndërtohet rruga për këmbësorët mbi kurorën e argjinaturës, do të bëhet mbrojtja e kurorës nga erozioni që shkaktojnë rebeshët e shiut. Mbrojtja e kurorës së argjinaturës nga erozioni do të realizohet me membranë gjeosintetike me argjile të papërshkueshme nga uji (GCL) (Waterproof Geosynthetic Clay Liners Material GCL ).

#### 5.2.1.1 Membrane gjeosintetike me argjilë të papërshkueshme nga uji (GCL)

Membrana gjeosintetike me argjilë e papërshkueshme nga uji (GCL) është një barrierë hidraulike e përforcuar, e përbëra nga bentonit natriumi natyral i shpuar me gjilpërë dhe gjeotekstile.

Membrana e argjiles gjeosintetike të shpuar me gjilpërë (GCL) është nje përbërje e përforcuar me fibra që kombinojnë dy shtresa të jashtme të qëndrueshme dhe një bërthamë të ndërmjetme dhe uniforme pluhuri me ënjtje të lartë prej argjile bentonite natriumi. Kjo bërthamë unike prej balte vepron si përbërësi pengues, por performanca e saj përfundimtare varet nga qëndrueshmëria dhe siguria e ofruar nga shtresat e jashtme. Goditja e njëtrajtshme e gjilpërës formon një pengesë mbyllëse të pavarur nga drejtimi, që transferon stresin e prerjes. Kur bërthama e bentonitit hidratohet me ujë , bentoniti brymehet dhe formon një shtresë xhel me përshkueshmëri të ulët, e cila tejkalon veshjet tradicionale, të trasha të argjilës së ngjeshur, për shkak të aftësisë së bentonitit për t'u vulosur. GCL është me kosto efektive dhe miqësore me mjedisin.



Membrana e argjiles gjeosintetike (GCL) eshte një pengesë hidraulike e prodhuar nga fabrika e përbërë nga argjilë bentonite natriumi, e vendosur në mes, e mbështetur dhe e kapsuluar nga dy gjeotekstile, të mbajtura së bashku me shpim me gjilpërë.

Gjeotekstili - Një pëlhurë e endur e përshkueshme, jo e endur ose një kombinim i tyre që përdoret për të përmbajtur bentonitin e përdorur në një GCL.

Bentoniti i natriumit - Përbërësi i argjilës me ënjtje të lartë të GCL-ve që përbëhet kryesisht nga minerali Montmorillonite.

Shpimi me gjilpërë - Një proces prodhimi GCL ku dërrasat e gjilpërave me gjemba inkorporojnë fijet kryesore nga një gjeotekstili jo të endura, përmes një shtrese argjile bentonite natriumi, në matricën e një shtrese të dytë gjeotekstili.

Mbyllja termike - një proces prodhimi ku fibrat e ngatërruara trajtohen me nxehtësi për të rritur kapacitetin e brendshëm prerës dhe forcën mekanike të GCL.

### 5.2.1.2 Fushat e përdorimit

Membrana e argjilës gjeosintetike (GCL) përdoret me sukses në:

Diga dhe Argjinatura.

Kanalet e ujitjes

Riparimet e rrëshqitjeve dhe përforsimet e tokës

Zonat e depozitimit të mbetjeve të ngurta dhe mbetjeve të rrezikshme

Pellgje dhe pishina etj.

### 5.2.1.3 Veçoritë e membranës me argjilë gjeosintetike (GCL)

Dendësi e lartë dhe performancë e fortë e ujit vetë-mbajtës;

Performanca e përhershme e papërshkueshme nga uji;

Ndërtim i lehtë, periudhë e shkurtër ndërtimi' ka periudhën më të shkurtër të ndërtimit midis materialeve ekzistuese të papërshkueshme nga uji;

Nuk kërkon inspektim të veçantë pas ndërtimit;

Është e lehtë të riparohet;

Bentoniti është një material natyral inorganik, jo toksik dhe i padëmshëm për trupin e njeriut l gjelbër dhe miqësor ndaj mjedisit ;

Nuk ndikohet nga temperatura dhe nuk thyhet në kushte klimatike të ftohtë;




Figura 45: Shtresat e membranës me argjilë gjeosintetike (GCL)



Figura 46: Marketimi i membranës me argjilë gjeosintetike (GCL)

#### 5.2.1.4 GCL Standartet dhe Specifikimet

Kualiteti i membranës duhet të jetë sipas Specifikimeve të Projektit duke qënë në përputhje me EN ISO 9864, ASTM D5261, EN 14196, ASTM-D-5890, ASTM-D-5891, VDG P69 Methylene blue, EN 14196, EN ISO 9863-1, EN 964-1, dhe EN ISO 10319,

Materiali GCL duhet të jetë në përputhje me metodat e provës sipas standarteve:

EN ISO 9864 / ASTM D5261, EN ISO 9864 / ASTM D5261, EN 14196, ASTM-D-5890, ASTM-D-5891, VDG P69 Methylene blue, EN 14196 (p GBR-C), EN ISO 9863-1 (EN 964-1), EN ISO 10319 / ASTM-D-4595, ASTM-D-6496, EN ISO 12236 / ASTM D6241, EN 16416 / ASTM-D-5887, EN 12224:2000, CEN/TC 189, CEN/TC 189 / WG 6.

Materiali GCL duhet të jetë në përputhje me Specifikimet si ne Tabelën 3:

Specifikimet Teknike të materialit siç janë renditur më poshtë në tabelën 3 të dhenë:





**Specifikimet Teknike te veshjes gjeosintetike me argjilë (GCL)**

Karakteristikat e gjeotekstilit				shenime
Shtresa bazale			Nonwoven geotextile	
Shtresa e sipërme			Woven geotextile	
Polimer			Polypropylene	
Masa për njësi	EN ISO 9864	g/m <sup>2</sup>	Basal layer 200 - Upper layer 100	1
Karakteristikat e bentonitit				
Lloji			Sodium bentonite	
Pesha specifike		g/m <sup>3</sup>	2.60	
Pika e shkrirjes		°C	1340	
Përmbajtja e Montmorillonitit		%	90 (-10)	2.5
Thithja e ujit	ASTM E946	%	> 650	
Kapaciteti i ënjtjes së lirë	ASTM D5890	ml/2g	≥ 24	
Humbja e lëngjeve të bentonitit	ASTM D5891	ml	≤ 18	
Masa bentonite @ 12% përmbajtje lagështie	EN 14196	g/m <sup>2</sup>	3850	3
Karakteristikat e Përbëra (GBR-C).				
Masa për njësi	EN 14196	g/m <sup>2</sup>	4150	1.3
Trashësia	EN ISO 9863-1	mm	6.0	1
Forca e larte	ASTM D6496	N/10 cm	65	1,5,6
Përshkueshmëria	EN 16416 ASTM D5887	m/s	1.8x10 <sup>-11</sup> (+1.0x10 <sup>-11</sup> )	2.5
Fluksi i indeksit	EN 16416 ASTM D5887	m <sup>3</sup> /m <sup>2</sup> s	≤ 9.0 x 10 <sup>-9</sup>	
Rezistenca në tërheqje ( gjatësore )	EN ISO 10319	kN/m	12.0 (-2.5)	4
Zgjatja (gjatësore)	EN ISO 10319	%	20 (-5, +10)	2
Rezistenca statike ndaj shpimit - CBR	EN ISO 12236	kN	2.2 (-0.4)	4
Gjerësia e rrotullës		m	5.0 or 5.1	7

Tabela 3: Specifikimet teknike te materialit

Vlerat e bentonitit duhet të jenë sipas tabelës 4:

Bentoniti	Gama ose vlera
Përmbajtja e Montmorillonitit	≥ 80 wt. %(XRD)
Përmbajtja e karbonateve	≤ 1-2 wt. %
Forma e bentonitit	Natural Na-bentonite
Madhësia e grimcave	Pluhur (p.sh. 80% duke kaluar sitë 75 mikron)
Kapaciteti i shkëmbimit të kationeve	≥ 70 meq/100 g (ose cmol/kg)
Indeksi i fryrjes së lirë	≥ 24 ml/2g
Humbja e lëngjeve	≤ 18 ml

Shënim: Vlerat e deklaruara janë MARV ose MaxARV

Tabela 4: Specifikimet teknike të materialit bentoni

### 5.2.1.5 Prodhuesi GCL

Prodhuesi GCL i përzgjedhur, duhet të ketë një akreditim ISO 9001 (2008).

### 5.2.1.6 Kontrolli i cilësisë së prodhimit

Komponentët dhe GCL përfundimtar do t'i nënshtrohen testimit të rregullt dhe të shpeshtë në laboratorët e prodhuesit sipas standardit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 (2008).

GCL do të testohet për pajtueshmërinë me këtë specifikim nga metodat e provës dhe frekuencat e treguara në specifikimin e materialit ose sipas rastit.

Certifikatat e kontrollit të cilësisë do t'i lëshohen nga prodhuesi GCL kontraktorit. Certifikatat duhet të jenë të nënshkruara nga menaxheri i kontrollit të cilësisë së prodhuesit të GCL.

Se bashku me certifikatat e kontrollit të cilësisë, GCL do të shoqërohet dhe me udhëzimet e prodhuesit.

### 5.2.1.7 Dorezimi dhe rruajtja e GCL

GCL ofrohet në rrotulla me gjerësi 5m dhe gjatësi 40m. Diametri mesatar i rrotullës është 60-70 cm, dhe pesha është afërsisht 1000 kg. GCL është mbështjellë në bërthama të ngurta plastike me një diametër të brendshëm prej 10 cm. Çdo rrotull është i paketuar në një mëngë plastike rezistente ndaj UV. Të gjitha rrotullat janë të shënuara me një etiketë që përmban dimensionet, lotin dhe numrin e rrotullës.



Figura 47: Dorezimi i GCL

Çdo rrotull është i pajisur në një grup prej dy rripash ngritës. Rekomandohet që gjatë shkarkimit nga kamioni të vendosni një tub çeliku brenda për të parandaluar lakimin e rrotullës. Gjatë rruajtjes së GCL, mos i vendosni rrotullat drejtpërdrejt në tokë, por lejoni paletat ose trarët mbajtëse (druri) ose konstruksione të ngjashme poshtë rrotullave. Rrotullat nuk duhet të grumbullohen më shumë se 4 rrotulla të larta.



Figura 48: Rruajtja e GCL

Gjatë ruajtjes së rrotullave mos i vendosni direkt në tokë, por në paleta ose konstruksione të ngjashme poshtë. Rrotullat nuk duhet të ekspozohen drejtpërdrejt ndaj kushteve të këqija të motit gjatë ruajtjes.

Të gjitha rrotullat GCL duhet të paktohen në qese rezistente ndaj lagështirës. Bërthamat (çeliku ose plastika) duhet të jenë mjaftueshëm të forta për t'i rezistuar kolapsit gjatë tranzitit dhe trajtimit.

Prodhuesi duhet të etiketojë çdo rrotull, si në rrotullën GCL ashtu edhe në qesen që është future rrotulla GCL

Etiketat duhet të jenë rezistente ndaj zbehjes dhe degradimit të lagështirës për të siguruar lexueshmëri në momentin e instalimit.

Etiketimi minimal duhet te jete si vijon:

Gjatësia dhe gjerësia e rrotullës

Pesha totale e rrotullës

Lloji i materialit GCL

Emri i prodhuesit

Numri i Lotit të Prodhimit

#### 5.2.1.8 Përgatitja e siperfaqes ku do të vendoset GCL

Sipërfaqja e shtresës ne te cilen do te vendoset GCL duhet të jetë pa objekte të mprehta, lëndë organike dhe mbeturina të tjera më të mëdha se diametri 50 mm.

#### 5.2.1.9 Ngjeshja e siperfaqes ku do të vendoset GCL

Metoda më e zakonshme e ngjeshjes së dheut për të arritur nivelin e dëshiruar të ngjeshjes, është me një rul vibrues dhe duke sperkatur dheun me ujë. Shtresa duhet të ngjeshet të paktën 90% e densitetit maksimal të thatë. Shkalle e kerkuar e ngjeshjes do te arrihet përmes kalimeve të shumta nga pajisjet ngjeshese. Pas ngjeshjes duhet të sigurohet një sipërfaqe e pastër, e thatë dhe të lëmuar përpara vendosjes së GCL.



Figura 49: Ngjeshja e shtresave të dheut

### 5.2.1.10 Shtrimi i membranës me argjile gjeosintetike (GCL)

Pajisjet shtesë të nevojshme për instalimin e GCL-ve përfshijnë:

Thikë dhe tehe rezervë (për prerjen e GCL).

Bentoniti granular për tegelat GCL në fund të rrotullimit dhe për mbylljen rreth strukturave dhe detajeve. Bentoniti granular është i disponueshëm nga prodhuesi dhe do të përfshihet në cmimin per/m<sup>2</sup> të sipërfaqes së matur pas montimit të GCL.

Mbulesa të papërshkueshëm nga uji (për mbulim të përkohshëm në materialin e instaluar si dhe për rrotullat e grumbulluara).

Kapëse opsionale me tehe të sheshta (për pozicionimin e panelit GCL me dorë).

Roletat GCL duhet të dërgohen në zonën e punës të vendit në paketimin e tyre origjinal.



